



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHDI

Drejtoria e Bujqësisë Pyjeve dhe Kullotave
Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave

Nr. _____ Prot.

Librazhd, më ____/____/2026

Lënda: Kthim përgjigje

Dërgohet: znj.Fatbardha Nergjoni

Adresa: Hotel turizmi Skampa , Cel: 0695688008

Përsa kërkoni në Tuajën ,sa I përket menaxhimit të fondit pyjor e kullosor, ju sqarojmë si më poshtë vijon :

■ Sa është sipërfaqja totale e pyjeve dhe kullotave në administrim të bashkisë dhe sa përqind e saj është e pajisur me plane mbarështimi të përditësuara?

Sipërfaqja totale e bashkisë Librazhd e fondit pyjor/kullosor është 37803.0186 ha.
Sipërfaqja që është mbuluar me plane mbarështimi është reth 20% ose 7560.6 ha.

Për vitin 2026 bashkia Librazhd ka planifikuar të hartojë plan mbarështimi edhe për ekonomi të tjera pyjore në mënyrë që të rritet sipërfaqja e inventarizuar. Planifikimi për plane mbarështimi është bërë në vlera që përballohen nga buxheti i bashkisë pasi për disa ekonomi pyjore kostoja e tyre është shumë e lartë për hartimin e tyre.

■ Cilat janë kapacitetet aktuale njerëzore dhe logjistike për menaxhimin e pyjeve (numri i punonjësve, strukturat përgjegjëse, pajisjet në dispozicion)?

Aktualisht në struktura përgjegjëse për pyjet është e përfshirë në 2 drejtori të ndryshme :
Drejtoria e Bujqësisë Pyjeve dhe Kullotave e cila në strukturën e saj përfshin Sektorin e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave me 3 punonjës
Drejtoria e Funksioneve të Patransferueshme që përfshin strukturën e Mbrojtjes së Pyjev dhe Kullotave me 6 punonjës dhe 1 punonjës inspektor mjedisi.
Struktura që merret me menaxhimin dhe mbrojtjen kanë në dispozicion një mjet foristradë për lëvizje në terren. Ndërsa për të kryer matjet dhe orientimin kanë hipsometër,busulla,diametër matës.

■ Çfarë investimesh janë kryer ose planifikohen për forcimin e kapaciteteve në menaxhimin e pyjeve dhe mbrojtjen nga zjarret?

Nga struktura përgjegjëse për pyjet janë planifikuar masa mbrotëse për hapjen e koridoreve në sipërfaqet pyjore. Gjithashtu në kullota janë investuar dhe planifikuar për investim vepra ujore që mbajnë ujë gjatë sezonit të verës. Kjo me qëllim për ujë të pijshëm për blegtorinë por edhe për funksion mbrojtës për parandalim të zjarreve në momentet e para në këto sipërfaqe.

🏛️ A ka plane konkrete për rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e shërbimeve në funksion të mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm?

Bazuar në legjislacionin në fuqi ,me këto sipërfaqe që bashkia Librazhd ka në pronësi numri I punonjësve duhet të jetë më I lartë,pasi kemi ekonomi pyjore me pyje të lartë ku menaxhimi dhe mbrojtja e tyre kërkon staf më shumë. Bashkia Librazhd është bashki e vogël dhe me vetëfinancim nuk është shumë e mundur rritja e stafit të punonjësve por në rast mbështetje në financimin e pagave ky numër punonjësish mund të rritet.

Bashkëngjitur po ju dërgojmë foto të pyjeve të larta në territorin e bashkisë Librazhd

Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin!

KRYETARI I BASHKISË

Mariglen Disha